



## GAZMEND ZENELI DOKTOR I SHKENCAVE

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Gazmend Zeneli është  
Lektor ne Departamentin e Turizmit,  
Mikpritjes dhe Rekreacionit

### FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Mjedis dhe Turizëm

### EMAIL

[g.zeneli@umb.edu.al](mailto:g.zeneli@umb.edu.al)

## BIO

Dr. Gazmend Zeneli ka rreth 25 vite experiencë në punën kërkimore, shkencore dhe mësimdhënie. Ai mban gradën Doktor i Shkencave (Dr. rer. nat.) nga Universiteti Friedrich Schiller në Jena (Gjermani) pas disa vitesh pune kërkimore në Max Planck Institute for Chemical Ecology po në Jena (Gjermani) dhe Master i Shkencave (M.Sc), në shkencat e mjedisit nga Mediterranean Agronomic Institute i Chania-se (Greqi). Gjatë kësaj periudhe Dr. Zeneli ka punuar në disa nga qendrat më të rëndësishme kërkimore apo Universitare ndërkombëtare, si: Max Planck Institute for Chemical Ecology; Technical University of Dresden; Leibniz Institute of Ecological Regional Development, etj.

Ai ka qene fitues i disa granteve për hulumtime dhe rezultatet e aktivitetit të tij shkencor janë botuar ne mbi 30 artikuj shkencorë në disa nga revistat më të njohura në fushën e mjedisit. Po ashtu këto rezultate janë prezantuar në mbi 45 konferenca ndërkombëtare.

Përvojat e tij në menaxhim janë të shumta: nga drejtues projekti dhe menaxher i projekteve të ndryshme deri në Drejtor i Institutit për Kërkim dhe Zhvillim "Barleti", dhe nga drejtues departamenti deri në Dekan Fakulteti.

Dr. Zeneli eshte i angazhuar prej rreth 15 vitesh ne jeten akademike si pedagog dhe aktualisht është lektor i disa lëndëve në programet e studimit Bachelor dhe Master në Universitetin "Barleti". Ai flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe atë gjermane dhe është Lektor i Ftuar i Universitetit të Evropës Juglindore të Tetovës (Maqedonia e Veriut) dhe Universitetit të Arkansas, Clinton School of Public Service (SHBA).